

EC-

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-58829  
Më 3.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.6.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material shpenzues (pajisje), dhe mori këtë

### KONKLUZION



Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 26.5.2014, për lejimin e furnizimit me material shpenzues (pajisje) për nevojat e kësaj Drejtorie, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për furnizim me:

1. Një aparat për fotokopje A1,
2. Dy seknera,
3. Pesë rapitografa 0.3,
4. Pesë rapitografa 0.5,
5. Tre fotoaparate digjitale,
6. Pesë kompjuter me konfiguracionet për programet CAD,
7. Tre metra digjitale dhe dhjetë metra të thjeshta,
8. Dymbëdhjetë USB-16 GB,
9. Dy digtafona,

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga data e miratimit.

  
 Kryetari i Komunës  
 Prof. Dr. Ramadan Muja  


REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-62173

Më 3.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për formimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në shtëpinë e familjes Qavolli, kryetari i Komunës, me 3 qershor 2014, mori këtë

A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Komisioni profesional për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në shtëpinë e familjes Qavolli. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:


- a. Refki Musbegu, nga DUPH,
- b. Naser Temaj, nga DES, dhe
- c. Enver Bytyqi, nga DI.

II. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë: të bëjë një vlerësim real dhe profesional lidhur me gjendjen fizike të objektit-shtëpisë së familjes Qavolli e cila gjendet në rrugën "Vatrat Shqiptare" në ng. Kadastrore 338/3, e cila shtëpi-objekt pretendohet së është dëmtuar nga fqinji i tij. Pas këtij vlerësimi, komisioni, duhet të japë një raport me shkrim me rekomandime lidhur me objektin në fjalë. Komisioni mund të marrë edhe veprime të tjera konform ligjit lidhur me këtë rast.

III. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, të emëruarit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-58829

Më 3.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.6.2014 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për blerjen e programit (softuerit) për aplikim për certifikata nga distanca, dhe mori këtë

### KON KLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 26.5.2014, për lejimin e blerjes së programit (softuerit) për aplikim për certifikata nga distanca përmes ueb-faqes së Komunës, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-58829

Më 3.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 3.6.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e të gjitha objekteve shëndetësore, dhe mori këtë


### KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 27.5.2014, për lejimin e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të të gjitha objekteve shëndetësore të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-58829

Më 3.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 3.6.2014, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për mbushjen dhe servisimin e aparateve kundër zjarrit, dhe mori këtë


### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 27.5.2014, për lejimin e mbushjes dhe servisimit të aparateve kundër zjarrit të cilat gjenden në objektet shëndetësore të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-58829

Më 3.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 3.6.2014, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për dhënien në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta në Prizren, dhe mori këtë

### KON KLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 19.5.2014, për lejimin e dhënies në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për dhënien në menaxhim të këtyre vendgjuetive:

1. Vendgjuetia "Rrafshi" në sip. 14.518.25 ha,
2. Vendgjuetia "Sharri I" në sip. 10.702.10 ha,
3. Vendgjuetia "Sharri II" në sip. 12.730.45 ha,
4. Vendgjuetia "Koritniku" në sip. 11.832.30 ha,
5. Vendgjuetia "Pashtriku" në sip. 13.684.60 ha.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-58829  
Më 3.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 3.6.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për rrallimin (prerjen) parakomerciale në pyjet e zonës së Pashtrikut dhe Koretnikut, dhe mori këtë


### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 18.5.2014, për lejimin e rrallimit (prerjes) parakomerciale në pyjet e zonës së Pashtrikut dhe Koretnikut, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-58829

Më 3.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.6.2014 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për riparimin e disa rrugëve fushore, dhe mori këtë

### KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 22.5.2014, për lejimin e riparimit (rregullimit) të rrugëve fushore në gjatësi prej 10 km, në fshatrat Zojz, Medvec, Kobaj dhe Zhur, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-62176  
Më 3.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për Teatrin Profesional të Prizrenit, kryetari i Komunës më 3 qershor 2014, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 26.5.2014, për përkrahje financiare për Teatrin Profesional të Prizrenit, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve lidhur me realizimin e projekteve teatrore të parapara për vitin 2014( katër projekte), kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 7000 €.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Teatri Profesional si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.




Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-62178  
Më 3.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për KF "Liria", kryetari i Komunës më 3 qershor 2014, miratoi këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 27.5.2014, për përkrahje financiare për KF "Liria", me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për nevojat e klubit, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete financiare në lartësi prej 8290 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KF "Liria", si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-62183  
Më 3.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e futjes së numrave të telefonave mobil të punëtorëve të QPS-së në rrethin e telefonisë mobile të Komunës, kryetari i Komunës më 3 qershor 2014, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e futjes së numrave të telefonave mobil të punëtorëve të QPS-së në rrethin e telefonisë mobile të Komunës si dhe për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të këtij abonimi, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës -- pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyra e IT-së dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

### Neni 4

Më këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-62192  
Më 3.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për Shoqatën e Pensionistëve të Kosovës, kryetari i Komunës më 3 qershor 2014, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në kërkesën e Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës - dega në Prizren, për mbështetje financiare për organizimin dhe shënimin e 60 vjetorit të themelimit të kësaj Shoqate, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumaën 1000 €.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Kryetarit të Komunës.

### Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Shoqata, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-62197  
Më 3.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Çështje Gjinore, kryetari i Komunës, me 3 qershor 2014, mori këtë

## AKTIVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Bordi Komunal për realizimin e Peticionit “Kërkojmë Drejtësi Ndërkombëtare për Gratë e Dhunuara gjatë Luftës së fundit në Kosovë”.

Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Prof. dr. Ramadan Muja, kryetar i Komunës,
- b. Mybezhel Zhuri, zyrtare për barazi gjinore,
- c. Luljeta Abdiq, nga OJQ “Dora Dorës”,
- d. Drita Vukshinaj, nga OJQ “Femra për Femrën”.
- e. Ajshe Shala, kuvendare e Kuvendit të Komunës së Prizrenit,
- f. Fahrije Bytyqi, kuvendare e Kuvendit të Komunës së Prizrenit,
- g. Hasan Gjonbalaj, nga Zyra Rajonale e Statistikës Komunale

II. Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi do të funksionoj dhe veproj sipas Udhëzimeve të nxjerra nga ana e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe akteve të tjera ligjore që janë në fuqi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Zyra për Çështje Gjinore dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: Zyra për Çështje Gjinore, të emëruarit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-58829  
Më 3.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.6.2014 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e shpalljes së tenderit për blerjen e një automjeti për nevojat e kësaj Zyre, dhe mori këtë


### KON KLUZION

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 27.5.2014, për lejimin e blerjes së një automjeti (xhip) për nevojat e kësaj Zyre, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-66935  
Më 17.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17.6.2014 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për mirëmbajtjen e Komplekseve Memoriale të Luftës së UÇK-së në Komunën e Prizrenit, dhe mori këtë

### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 11.6.2014, për lejimin e mirëmbajtjes së Komplekseve Memoriale të Luftës së UÇK-së në Komunën e Prizrenit, i cili që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Mujic

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-70378

Më 17.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve për Nexhat Çoçaj, drejtor i DASH dhe Reshit Kushajn, zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 17 qershor 2014, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Nexhat Çoçajt, drejtor i DASH dhe Reshit Kushajt, zyrtar komunal, për në Tiranë të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në seminarin që ka të bëjë me modalitetet e reja të bashkëpunimit ndërkombëtar për programet që janë duke u zbatuar në Komunën e Prizrenit, përkatësisht për ndihmën për nxënësit me nevojat e veçanta. Ky seminar organizohet nga "Save the Children" dhe i njëjti do të realizohet nga data 20 qershor deri me 21 qershor 2014, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurit.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

### Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja




REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-70381  
Më 17.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e mjeteve për përkrahje financiare për realizimin e Festivalit të filmit dokumentar dhe të shkurtër "DOKUFEST 2014", kryetari i Komunës më 17 qershor 2014, miratoi këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejin e mjeteve për përkrahje financiare për realizimin e edicionit të 13-të të festivalit të filmit dokumentar dhe të shkurtër "DOKUFEST 2014", që mbahet gjatë muajit gusht në Prizren, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën prej 15.000 € (pesëmbëdhjetëmijë euro).
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin I të këtij Vendimi, lejohen si në vijim:
  - a. 10.000 € (dhjetëmijë euro) nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- pozicioni i subvencioneve, dhe
  - b. 5000 (pesëmijë euro) nga Zyra e Kryetarit të Komunës- pozicioni i subvencioneve.
- III. Çdo shërbim tjetër i ofruar nga ana e Komunës së Prizrenit lidhur me realizimin e festivalit të lartcekur, Komuna e Prizrenit e llogarit si mbështetje financiare dhe e konsideron si donacion për këtë qëllim.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- V. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, organizatori, si dhe arkivi.
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-66935  
Më 17.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17.6.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e projektit: "Trajnimi i agjencioneve turistike për përpilimin e pakove turistike", dhe mori këtë


### KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 11.6.2014, për lejimin e realizimit të projektit: "Trajnimi i agjencioneve turistike për përpilimin e pakove turistike", kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-66935  
Më 17.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17.6.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejinin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit “Rindërtimi i konakut-shtëpisë muze të Famullisë së Zymit”, dhe mori këtë


### KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 11.6.2014, për lejinin e hartimit të projektit: “Rindërtimi i konakut-shtëpisë muze të Famullisë së Zymit ku ka jetuar dhe vepruar At Shtjefën Gjeqovi”, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramëdhan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-66935  
Më 17.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17.6.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit "Hapja dhe rregullimi i trasesë pranë bregut të Drinit të Bardhë nga ura e fshatit Gjonaj deri te ura në fshatin Nashec", dhe mori këtë


### KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 11.6.2014, për lejimin e hartimit të projektit: "Hapja dhe rregullimi i trasesë pranë bregut të Drinit të Bardhë nga ura e fshatit Gjonaj deri te ura në fshatin Nashec", kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-66935

Më 17.6.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 17.6.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me rroba pune (veshmbathje) për punëtorët sezonal të Brigadës së Zjarrfikësve, dhe mori këtë

### KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 13.6.2014, për lejimin e furnizimit me rroba pune (veshmbathje) për punëtorët sezonal të Brigadës së Zjarrfikësve, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për furnizim me:

- a. 20 palë rroba pune,
- b. 20 palë këpucë pune, dhe
- c. 40 copa bluza.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-70385  
Më 17.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për OJQ "X40", kryetari i Komunës më 17 qershor 2014, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e OJQ "X40", për mbështetje financiare për organizimin e aktiviteteve tradicionale të lëshimit me goma në Lumbardhë i quajtur "Bunar fest 2014". Ky aktivitet pritet të mbahet në fund të muajit qershor, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 1500 €.

### Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, OJQ "X40", si dhe arkivi.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-70387  
Më 17.6.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës, me 17 qershor 2014, mori këtë

## AKTVENDIM

- I. Formohet dhe emërohet Komisioni Komunal për inspektimin e të gjitha punimeve që janë duke u zhvilluar në Komunën e Prizrenit.

Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Njazi Kryeziu, drejtor i DUPH, kryesues i komisionit,
- b. Hasan Hasani, drejtor i DShP-së,
- c. Nexhat Çoçaj, drejtor i DASH-së,
- d. Zyber Rizanaj, drejtor i DSh-së,
- e. Pal Geci, drejtor i DBZhR-së,
- f. Elhame Berisha, drejtoresh e DPMS-së,
- g. Arhim Ajazi, drejtor i DKRS-së,
- h. Bedri Bytyqi, drejtor i DI-së,
- i. Mensur Bytyqi, drejtor i DTZhE,
- j. Ilir Baldedaj, drejtor i DA-së, anëtar.

- II. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë: të bëjnë inspektimin e të gjitha punimeve që janë duke u zhvilluar në Komunën e Prizrenit e të cilat janë investime të Komunës së Prizrenit. Ky komision do të veproj edhe sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të kryesuesit të këtij komisioni, që kanë të bëjnë me inspektimin e këtyre punimeve. Pas këtij inspektimi, komisioni, duhet të japë një raport me shkrim, kryetarit të komunës, me rekomandime lidhur me hapat e mëtutjeshëm që kanë të bëjnë me punimet e lartcekura.

- III. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen kryesuesi i komisionit dhe të emëruarit.

- IV. Me këtë Aktvendim të njoftohen: kryesuesi i komisionit, të emëruarit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja